

208 MATERIALET MUZIKORE TË SHYTPURA

Fusha përmban të dhëna të përshkruara nga njësia që ka të bëjë me formën e veçantë të një materiali muzikor të shtypur ose dorëshkrimi të një materiali me nota. Fusha përputhet me zonën e të dhënave të veçanta për materialet muzikore të shtypura në ISBD(PM).

Nënfushat & përsëritshmëria

| FUSHA/NËNFUSHA | | PËRSËRITSHMËRIA | |
|----------------|----------|---|----|
| 208 | | Materialet muzikore të shtypura | nr |
| | a | <i>Të dhënat e veçanta për materialet muzikore të shtypura</i> | nr |
| | d | <i>Të dhënat e veçanta paralele për materialet muzikore të shtypura</i> | r |

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

208a Të dhënat e veçanta për materialet muzikore të shtypura

Të dhënat për formën e veçantë të njësisë, të përshkruara nga faqja e titullit.

208d Të dhënat e veçanta paralele për materialet muzikore të shtypura

Të dhënat për formën e veçantë të njësisë në një gjuhë dhe/ose shkrim tjetër, të përshkruara nga faqja e titullit (shih shembujt 2, 3, 6). E përsëritshme për të dhënat paralele shtesë (shih shembullin 4).

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Të dhënat paralele (të dhënat e përsëritura në një gjuhë dhe/ose shkrim tjetër) që paraqiten në njësi, sipas ISBD-së paraprihen nga shenja e barazimit. Në nënfushën 208d shenja e barazimit vendoset në mënyrë automatike (shih shembujt 2, 3, 4, 6). Të dhënat në fushën 208 duhet të përputhen me të dhënat e koduara në fushën 125 (shih shembujt 2, 3, 4, 5, 6).

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

125 REGJISTRIMET ZANORE DHE MATERIALET MUZIKORE TË SHTYPURA

Fusha përmban të dhëna të koduara për regjistrimet zanore dhe materialet muzikore të shtypura.

SHEMBUJ

1.

| | | | |
|-----|----|---|-----------------|
| 208 | uu | a | Miniature score |
|-----|----|---|-----------------|

2. *

| | | | |
|-----|----|----|------------------|
| 125 | uu | aa | by |
| 208 | uu | a | Partitura dScore |

(Regjistrimi për një partiturë muzikore me titull "Concertino za piccolo in orkester", (shih shembullin 3). Të dhënat në fushën 208 duhet të përputhen me të dhënat e koduara në fushën 125.)

3. *

| | | | |
|-----|----|----|-------------------------------------|
| 125 | uu | ac | by |
| 208 | uu | a | Klavirski izvlaček dPiano reduction |

(Regjistrim për një partiturë vokale të shoqëruar me piano, me titull "Concertino za piccolo in orkester", (shih shembullin 2).)

4. * COBISS.net

| | | | |
|-----|----|----|--|
| 125 | uu | aa | by |
| 208 | uu | a | Partiturë për ekzekutim dSpielpartitur dPerforming score |

(Regjistrim që përmban të dhëna paralele; çdo e dhënë paralele shënohet në një nënfushë të përsëritshme d.)

Shfaqja në formatin ISBD:

Partiturë për ekzekutim = Spielpartitur = Performing score

5. * COBISS.net

| | | | |
|-----|----|----|--------------------|
| 125 | uu | ac | by |
| 208 | uu | a | Fragment për piano |

(Regjistrim për një partitur vokale për piano.)

6. * COBISS.net

| | | | |
|-----|----|----|--|
| 001 | uu | 7 | cb |
| 125 | uu | ac | ba |
| 208 | uu | a | Извод за два клавира dReduction pour deux pianos |

(Shkrimi i katalogimit është cirilik (kodi në nënfushën 0017). Një formë e veçantë e muzikës së shtypur në faqen e titullit është në shkrim cirilik, ndërsa e dhëna paralele në gjuhën franceze është në shkrim latin.)